# DËSHMI ARKIVI

**A-440894**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | E diela para Lartësimit të Kryqit/ Kryepiskopi Joan: Sprovat e jetës duhen parë si mundësi shërimi |
| ADRESA | `https://www.cna.al/aktualitet/e-diela-para-lartesimit-te-kryqit-kryepiskopi-joan-sprovat-e-jetes-du-i474009` |
| BURIMI | cna.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 19:12:02 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 10:14:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a0becc973b018b4030b7a300f297634547df7fbbdd6711c250e154260dad1f3f` |
| TEKSTI | `9d8f22e187d40b8b7cb538de5ec27f5d9fa719d93abc96e98bee31b15b99cf75` |
| PAMJA | `10a4d1b19d6ec24c6fff824ae131e96e860953bbb0297566135d24e57fbdcc93` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `224c04bffb05b6036415e0225a5780880bfade1e962b4ba2750814d3cee66769` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/224c04bffb05b6036415e0225a5780880bfade1e962b4ba2750814d3cee66769`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English

# E diela para Lartësimit të Kryqit/ Kryepeskopi Joan: Sprovat e jetës duhen parë si mundësi shërimi

13 Shtator 2026, 12:14, Aktualitet CNA



Në prag të festës së Lartësimit të Kryqit, Kryepeshkopi Joan ka përcjellë një mesazh të rëndësishëm për besimtarët mbi kuptimin e Kryqit dhe sakrificës në jetën e përditshme.

Gjatë predikimit, Fortlumturia e Tij vuri theksin te fakti se vështirësitë dhe sprovat e jetës nuk duhen parë si ndëshkim, por si një mundësi shpirtërore shërimi, duke iu referuar edhe paralelizmit biblik të ngritjes së gjarprit të bronzit nga Moisiu në shkretëtirë.

Kryepeshkopi Joan ftoi besimtarët të meditojnë rreth kuptimit të kryqit, duke e integruar atë përmes pendesës, dashurisë dhe faljes në veprimet e përditshme, si e vetmja rrugë drejt paqes dhe shpëtimit shpirtëror.

> *"Në vargjet e etërve të kishës, kryqi vazhdimisht është në qendër. Me anë të kryqit erdhi gëzimin botë, themi ne. Si erdhi me anë të kryqit gëzimin në botë? Ne e dimë që kryqi ishte një shenjë e vdekjes, dhe ishte një torturë që përdornin fenikasit për skllevërit, e megjithatë Zoti pikërisht zgjodhi këtë instrument vdekje për ta sjellë instrumentin e jetës tonë, sepse kryqi solli shpëtimin e njerëzve. Ashtu siç Moisiu e ngriti kryqin, ashtu dhe kur Krishti u kryqëzua, madje fjala që përdoret në ungjill, pikërisht kjo gjë është: u ngrit në krye. Solli shpëtimin e gjithsecilit nga ne. Dhe këtë javë kisha na fton ne që të meditojmë rreth kryqit. Çfarë do të thotë kryqi në jetën tonë të përditshme? Të gjithë ne ankohemi kundër kryqit, çdo*

*vështirësi që ndodhi ne ankohemi kundër asaj, çdo gjë që të kemi brenda trupit tonë do ankohemi kundër asaj. Dhe në qoftë se ne nuk e pranojmë këtë gjë, nuk mund të shërohemi dot. Kryqet që na ndodhin ne nuk janë për të na dëmtuar, janë për të na shëruar.*

*Një shenjt i madh ka thënë këto fjalë: "Në jetë kam gëlltitur shumë gjëra, e duke i gëlltitur u shërova". Bën analogjinë ashtu si njeriu pi një ilaç që e gëlltit, dhe kur thotë kanë gëlltitur shumë gjëra, kishte ndërmend thonte këto fjalë: "Sa herë më kanë thyer, poshtëruar, shpifur kundër meje, më kanë bërë padrejtësira, i kam gëlltitur thotë, e kam pranuar kryqin". E duke e gëlltitur u shërova. Edhe ne nëpërmjet kryqit mund të shërohemi, sa herë i përgjigjemi të keqes me të keqe, shpifjes me shpifje, thashethemeve me thashetheme, ne nuk shërohemi, po bëhemi si ai, i cili ka bërë po të njëjtën gjë kundër nesh. Me anë të kryqit erdhi shpëtimi në botë, thotë vargjet që këndojmë ne vazhdimisht. Sepse kryqi është mjekimi, ne e dimë që destinacioni përfundimtar është ngjallja, por të shkojmë drejt kësaj gjalle duhet të kalojmë nëpërmjet kryqit. Prandaj dhe kryqi është shenja themelore e kishës, rrobat e priftërinjve të gjithë janë me kryqe, gjithë zbukurimet në kishë kudo kemi kryqin, sepse kryqi është vula e Krishtit në kishën tonë, kryqi është energji e perëndisë. Dhe kryqin duhet ta shohim si dashuri e perëndisë për ne. Zoti ka dashuri për gjithsecilin nga ne, por ne shpeshherë nuk e ndjejmë, nuk e ndjejmë se nuk e pranojmë kryqin dhe pas sakrifica ne nuk mund ta kuptojmë dot dashurinë e perëndisë.*

*Kryqi nuk është një magji që vumë kryqin nga jashtë dhe shpëtuam. Kryqi vërtet është brenda zemrës tonë, kur ne kryqëzojmë gjithçka të keqe që kemi, ligësitë, mendimet e këqija, pasionet e çrregulluara që ka çdo njeri, inatet, mërirat e gjithçka tjetër. Ky është mjekimi që jepet nëpërmjet kryqit, kur ne e pranojmë atë. Asnjë nuk mund të shpëtojë dot pa bërë sakrifica të mëdha, pa mundim, nuk mund të ketë dot fitim. Prandaj dhe kryqi është kaq i rëndësishëm në jetën e çdo të krishteri, por që ta bëjmë kryqin që të ketë efekt tek ne, duhet ta pranojmë. Ju tregon shpeshherë njerëzve një krahasim: i them njerëzit mund të besojnë në kryq, por nëse nuk e praktikojnë në jetën e përditshme, nuk do ketë dobi ky besim. Njerëzit mund të besojnë në perëndinë, por nëse nuk e praktikojnë mësimin e tij në jetën e përditshme, nuk do ketë dobi ky mësim, ashtu si antibiotikët. Njerëzit mund të besojnë tek ato, por nëse janë sëmurë e nuk e marrin në trupin e tyre antibiotikun, nuk do shërohen. E njëjta gjë është edhe për ne. Ungjilli është një libër i shenjtë, dhe një libër shumë i rëndësishëm, por ne duhet ta zbardhojmë në jetën tonë të përditshme.*

*Le t'i lutemi Zotit që të na japë mençuri, që ta kuptojmë kryqin, dhe jo vetëm ta kuptojmë, edhe ta pranojmë në jetën tonë, dhe ajo do kthehet në të mirën tonë. Prandaj dhe shën Pavli shkruan dhe thotë te fjala tek letra e romanëve: "Çdo gjë bashkëvepron për të mirë për ata që e duan perëndinë". Nëse ne do e duam perëndinë, e do e marrim kryqin me dëshirë, kryqi do kthehet në instrumentin tonë të jetës, e do shërojë çdo gjë të dëmtuar që është brenda trupit edhe shpirtit tonë. Kjo është arsyeja përse kisha ndalon kaq gjatë për kryqin. Do flasim sot, do flasim përsëri nesër që është lartësimi i kryqit, dhe përsëri do ndalemi te kryqi dhe të dielën që do vijë. Sepse kryqi është qendra e jetës krishterë, kryqi është mjeti që solli ngjalljen, e kryqi është mjeti që solli shërimin tonë",* u shpreh Fortlumturia e Tij, Kryepiskopi Joan. /**CNA**








## Të sugjeruara

Përplasja për pagat e magjistratëve/ Rama: Të gjithë të respektojnë Kushtetutën

Shuhen vatrat e zjarrit në të gjithë vendin

Gjergj Luca, sipërmarrësi që ngre qytete/ Fish City Apollonia, një ëndërr e bërë realitet

"Një situatë e tillë nuk është parë në botë"/ Pacolli: Aeroporti i Vlorës nuk duhet të mbetet peng i interesave të askujt

VIDEO/ Rrethohet Kryeministria, protestuesit zhvendosen në hyrjen e pasme të godinës

Zjarret dhe përmbytjet në vend/ Ministria e Mbrojtjes përditësime për situatën

Deputeti i PD-së nën hetim nga SPAK/ Këlliçi: Interesi i Ramës kërkon përndjekje të opozitës

FOTOLAJM/ Pankartat në protestën e 105-të kundër qeverisë, mesazhet e diasporës

Kërkohet dorëheqja e Ramës/ Nis protesta e 105 kundër qeverisë

Përplasjet për çështjen e pagave/ Gjyqtari Pëllumbi: SPAK mund të hetojë çdo person ndaj të cilit ka dyshime

## 105 ditë protestë kundër qeverisë/ Diaspora zbarkon në Tiranë

## 28 vjet nga vrasja e Azem Hajdarit/ Këlliçi: Vizioni dhe guximi e vendosën në krye të lëvizjes së dhjetorit

## Çështja e pagave të drejtësisë/ Meta: Konflikt i provokuar nga Rama

## CNA merr pjesë në IBC 2026/ Ngjarja kryesore e teknologjisë mediatike në Europë

## Moti i keq përfshin qarkun e Elbasanit/ Përmbyten rrugët, vështirësi në qarkullim

## Reshjet e shiut fikin zjarret/ Vetëm një vatër aktive

## Trafiku i drogës nga Kolumbia/ Hita: Janë arrestuar disa shtetas shqiptarë, njëri prej tyre i dënuar për vrasje

## Fillimi i vitit të ri shkollor/ Hita prezanton planin e masave

## Tensione te kantieri i muzeut hebraik/ Protestuesit përplasen me policinë

## "Liri për Çlirimtarët"/ Rama reagon në prag të vendimit për ish-krerët e UÇK-së

editorial

17:34 Editorial

**Pse Gjykata e Lartë nuk duhet ta lirojë nga burgu Erion Veliajn?**

**CNA LIVESTREAM**



Na ndiqni edhe në

acromax

19:53 Acromax / Aldor Nini

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.